



## LOCAL PARTNERSHIP AGAINST DRUG ABUSE AND JUVENILE DELINQUENCY



Projekt i ri i Organizatës së Shoqërisë Civile “Horizonti i Ri”

# Kundër keqpërdorimit të drogave

**Projekti ka për qëllim ngritjen e vetëdijes së të rinjve në lidhje me efektet e dëmshme të keqpërdorimit me drogën, si dhe fuqizimin e kapaciteteve lokale për parandalimin e sëmundjeve të varësisë, në komunën e Ulqinit**

Ulqin - Organizata e Shoqërisë Civile “Horizonti i Ri” ka njoftuar se fillon realizimin e projektit të ri me titull “Partnersiteti lokal kundër abuzimit të drogave dhe delikuencës së të miturve”, të cilin e mbështet Ambasada e SHBA në Podgoricë përmes Zyrës për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit.

Projekti ka për qëllim ngritjen e vetëdijes së të rinjve në lidhje me efektet e dëmshme të keqpërdorimit me drogën, si dhe fuqizimin e kapaciteteve lokale për parandalimin e sëmundjeve

të varësisë, në komunën e Ulqinit.

Objektivat specifike të këtij projekti janë: krijimi i partneritetit me institucionet relevante dhe veprimi i përbashkët në luftën kundër abuzimit të drogës në komunitetin lokal, mbështetje për administratën vendore në aktivizimin e Zyrës për Parandalimin e Narkomanisë, hartimi i Planit Lokal për luftën kundër narkomanisë.

Gjatë dymbëdhjetë muajve të ardhshëm, në kuadër të këtij projekti do të realizohen aktivitete të ndryshme me karakter edukativ dhe promovues.

Nga “Horizonti i Ri” kanë njoftuar se ndër aktivitetet më të rëndësishme të projektit do të jenë: krijimi i partneriteteve lokale, formimi i ekipit ndërsektorial, trajnimi për fuqizimin e të rinjve për përfshirje në komunitet, hulumtimi me nxënës (14-18 vjeç) për problemet e sëmundjeve të varësisë, botimi i udhëzuesit “Fëmijët në konflikt me ligjin”, si dhe ngjarje të tjera publike.

Projekti do të përfundojë me hartimin e Planit Lokal për reduktimin e kërkesës për drogë dhe parandalimin e krimit të të miturve.

(Kohapress)